

**VENDIM**  
**Nr. 699, datë 21.11.2018**

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT “PËR MASAT PËR NXITJEN E TË NXËNIT,  
TË VIJUESHMËRISË DHE PËRPARIMIT TË NXËNËSVE TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE  
“NAIM FRASHËRI”, KORÇË, PËR VITIN SHKOLLOR 2018–2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e 350 (treqind e pesëdhjetë) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2018–2019.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore, që do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës, në formën e shërbimit ushqimor ditor, të pakeluar për çdo nxënë, për 170 (njëqind e shtatëdhjetë) ditë mësimore, jepet sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Njësia arsimore vendore të paraqesë pranë njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, Bashkia Korçë, listën emërore të nxënësve që ndjekin studimet në këtë institucion arsimor, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore dërgohet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuota ushqimore rishpërndahen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për Bashkinë Korçë dhe administrohen nga kjo Bashki.

5. Njësia arsimore vendore dhe drejtorja e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënësve, të vijueshmërisë dhe përpërimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës “Naim Frashëri”, Korçë. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit para-universitar”.

6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nga buxheti vjetor i miratuar, të mbulojë edhe rimbursimin e Bashkisë Korçë për pagesat e kryera, për programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar, për vitin shkollor 2017–2018, në vlerën 3 449 000 (tre milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Korçë dhe njësia arsimore vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

PASQYRA NR. 1  
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE (VITI  
MËSIMOR 2018–2019)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar/njësi	Vlera ditore/në lekë
1	Bukë	gram	120	341.95	100	12.0
2	Makarona	gram	10.5	37.45	120	1.3
3	Oriz	gram	10.5	38.15	150	1.6
4	Sheqer	gram	14	54.95	100	1.4
5	Fasule	gram	10.5	32.55	150	1.6
6	Perime	gram	45.5	9.45	100	4.6
7	Fruta	gram	35	14.7	100	3.5
8	Vaj	gram	10.5	94.5	180	1.9
9	Gjalpë	gram	7	53.2	531	3.7
10	Mish	gram	31.5	45.5	750	23.6
11	Djathë	gram	8.75	14	400	3.5
12	Reçel	gram	7	32.55	250	1.8
13	Vezë	kokërr	0.35	14.7	12	4.2
14	Qumësht	gram	70	34.3	80	5.6
15	Patate	gram	70	59.5	40	2.8
16	Nënprodukte pule dhe mishi	gram	10.5	35	400	3.2
	<b>Kuota ditore</b>			<b>912.45</b>		<b>76</b>

**Shënim.** Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme dhe çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).